



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut", të ndryshuar".

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Ardiana Jaku, Almira Xhembulla, Majlinda Halilaj, Florenc Spaho, Eugen Bojaxhiu, Amra Barova, Koçi Tahiri, Edmond Stojku, Halil Jakimi, Ervis Meço,

Mungojnë:

Roland Xhelilaj, Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho – Kryeinspektore në Inspektoratin Shëndetësor Shtetëror

Antoneta Njehrrëna – Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ardian Paravani – përfaqësues i ISHSH-së

Oligert Kume – përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Edlira Llango – Drejtoreshë e Legjislacionit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Jolanda Hykaj – përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik

Enkeleda Kadiu – përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik

Entela Bushi – përfaqësuese e Institutit të Shëndetit Publik

Mariana Bukli – përfaqësuese nga UNICEF

Hari Lena – përfaqësues nga “Hari Lena Group”

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Mirëmëngjesi!

Hapim mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, të ndryshuar”.

Të ftuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kemi zotin Oligert Kume, nga Instituti i Shëndetit Publik prezent kemi zonjat Jolanda Hykaj, Enkeleda Kadiu dhe Entela Bushi, nga UNICEF-i kemi zonjën Mariana Bukli, nga grupi “Hari Lena” kemi vetë Hari Lenën, nga Ministria e Shëndetësisë marrin pjesë: zonja Mira Rakacolli, zëvendësministre e Shëndetësisë, zonja Vjollca Braho, kryeinspektore e Inspektoratit Shëndetësor, zonja Antoneta Njehrrëna, drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe Ardian Paravani nga Inspektorati Shëndetësor. Nga Ministria e Bujqësisë merr pjesë zonja Edlira Llango.

Unë dua të flas pak për deficencën jodike, për të gjitha grupet e interesuara këtu, e cila është një nga problemet më madhore të shëndetit publik në Shqipëri. Ky problem është aq i rëndësishëm sa edhe vetë Asambleja Botërore e Shëndetësisë në vitin 1991 vendosi si objektiv eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike. Këtë nismë e mbështetën edhe udhëheqësit botërorë dhe u mbledhën në samitin botëror për fëmijët e Kombeve të Bashkuara, e cila u ripohua në konferencën ndërkombëtare të ushqimit në vitin 1992. Fondi Ndërkombëtar i Emergjencave të Kombeve të Bashkuara për Fëmijë, UNICEF-i, rekomandon jodizimin e rëndësishëm të kripës, si strategji kryesore për të arritur eliminimin e çrregullimeve nga pamjaftueshmëria jodike. Në vitin 2005 rëndësia e eliminimit të çrregullimeve nga jodi u pohua nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara për Shëndetësinë, e cila miratoi një rezolutë të veçantë për raportimin e Organizatës Botërore për çrregullimet nga pamjaftueshmëria e jodit. Në vitin 2013 Asambleja Botërore e Shëndetësisë njohu më tej faktin se lufta kundër çrregullimeve të jodit kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e fëmijëve, duke përfshirë edhe vendet e varfra, ndikon në uljen e vdekshmërisë foshnjore, në shëndetin e nënës dhe në arsim.

Për sa i përket vendin tonë, Shqipëria ka pasur një deficencë jodike endemike, problematike dhe madhore. Të mos harrojmë se ky problem ka qenë më madhor në vitin 1990 dhe është reduktuar si pasojë e zhvillimit të politikave në fushën e shëndetësisë. Gjithsesi,

përdorimi i kripës së jodizuar në Shqipëri ka rënë. Në raportimin e fundit të bërë nga **DIGS**, kemi 65% të shqiptarëve që përdorin kripë të jodizuar.

Nuk dua të zgjatem shumë, por besoj se asnjë nga ju nuk do të donte të shikonte fotografi fëmijësh shqiptarë me deficiencë jodike, pra me prapambetje mendore, ku kostoja e shëndetit për këta fëmijë është shumë herë më e madhe, sesa disa pjesë të industrisë që e ngrenë si problem për këtë fushë. Pra, ne nuk duhet të lejojmë që fëmijët të lindin me deficiencë jodike, sepse për rritjen e vetëm një fëmije invalid kostoja është shumë herë më e madhe, sesa e gjithë ajo përpjekje që bëhet në disa segmente për të kufizuar përdorimin e kripës së jodizuar në Shqipëri. Unë ju ftoj të gjithëve që të merrni pjesë në këtë nismë, sepse është qytetare, profesionale, politike dhe shëndetësore. Në këtë shekull që kemi hyrë fëmijët tanë duhet të lindin të shëndetshëm. Mjafton që të gjitha nënat të fillojnë përdorimin e kripës së jodizuar 100%, atëherë vitin që vjen nuk do të kemi asnjë fëmijë që lind me deficiencë jodike. Pra, efekti është i menjëhershëm mbas një viti.

Duke mos dashur të zgjatem, unë shpreh mbështetjen time për këtë nismë shumë të mirë të qeverisë, e mbështes edhe si profesionist dhe kjo duhet të hyjë në zbatim sa më shpejt.

Tani do të dëgjomë me radhë grupet e interesit dhe po fillojmë me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Fjalën e ka Oligerti.

Oligert Kume – Së pari, në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave më lejoni t’ju falënderoj për mundësinë që na krijuat për të shprehur opinionin tonë në lidhje me ndryshimet e këtij projektligji, konkretisht në ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është informuar për ndryshimet në projektligj dhe u vumë në lëvizje për të asistuar dhe për të qenë pjesë e këtij komisioni. Ne kemi parashtruar disa propozime, që ky komision t’i marrë në konsideratë, që lidhen me disa shtesa, ndryshime apo amendime të këtij projektligji të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Bujqësisë. Këto ndryshime, që vijnë si propozim i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, marrin në konsideratë ankesat, sugjerimet apo vlerësimet nga grupe të ndryshme interesi, siç janë bizneset që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në këto ndryshime, që aktualisht ndodhen përpara jush, nuk merren në konsideratë një pjesë e konsiderueshme e industrisë, të cilët e përdorin kripën me jod apo të pajodizuar për aktivitetin e tyre në kushtet e një regjimi të përpunimit aktiv. Vetë kartat teknologjike që disponojnë këta operatorë e njohin si procedurë kryesisht për prodhimet e produkteve të detit, të cilat kanë një përqindje shumë të lartë të jodit. Kartat teknologjike të miratuara edhe nga autoriteti doganor normojnë këtë procedurë, përmes

së cilës detyrohen që kripën e pajodizuar ta trajtojnë si lëndë të parë dhe jo si një produkt të gatshëm apo për konsum njerëzor. Konkretisht në nenin 3 të projektligjit të bëhet ndryshimi si më poshtë: “Të lejohet importimi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm për ata operatorë ekonomikë, të cilët përdorimin e saj e kryejnë për procese teknologjike të regjimit dhe përpunimit, me qëllim eksportin e një produkti të caktuar”. Çfarë nënkuptojmë me këtë? Kripa e pajodizuar e importuar vjen në territorin e Republikës së Shqipërisë si lëndë e parë, trajtohet për produktet që do të eksportohen në një shtet tjetër dhe lënda e parë shërben si një element stazhinimi apo trajtimi të produktit që më pas ambalazhohet dhe eksportohet në destinacionin e porositësit. Pra, kjo industri, ku aktualisht në Shqipëri operojnë rreth 14 operatorë, në kushtet e këtij regjimi të përpunimit aktiv, deri tani i ka trajtuar produktet e tyre finale edhe përmes kripës, duke i lënë produktet në territor apo në fushë të hapur, gjithmonë me synimin se duke i lënë në fushë të hapur niveli i jodit fillon të minimizohet përmes kushteve atmosferike. Por kanë qenë jo të vogla rastet kur produktet e eksportuara, porositësi i ka konstatuar me probleme që kanë ardhur edhe si rrjedhojë e kësaj situatë.

Njëkohësisht, vlerësojmë se është për t’u analizuar edhe elementi tjetër. Pra, lejohet importimi i kripës së pajodizuar për qëllime shëndetësore apo industriale, në të cilat nuk mund të përdoret kripa e jodizuar nga subjekte të licensuara për këtë qëllim, sipas legjislacionit në fuqi. Grupet e interesit nuk janë për të ndryshuar pikën e parë të nenit 3 të projektligjit, që është neni 6 i ligjit nr. 9942, pasi nënkuptojmë edhe kompanitë e kontraktuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për pastrimin e rrugëve. Në këtë këndvështrim, sot legjislacioni nuk e lejon importimin e kripës së pajodizuar, që mund të jetë hasur edhe në zhargonin e përditshëm si kripë e zezë, e cila përdoret edhe për pastrimin e rrugëve. Në këtë këndvështrim vlerësojmë se mbi bazën e licencave, që duhet të disponojnë këto subjekte, të lejohet edhe importi për këta operatorë ekonomikë për qëllim industrial në bazë të aktivitetit të tyre, kur janë të licencuara dhe të kontraktuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Në të njëjtën kohë, në nenin 3 të projektligjit të propozuar thuhet: “Të lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar në vende ku nuk ekziston ndalimi i përdorimit të kripës së pajodizuar”. Tekstualisht ka ardhur në këtë formë propozimi për ndryshim.

Më lejoni t’ju them se sistemet doganore aktualisht e kanë të pamundur të verifikojnë *online* se cilat vende e kanë të lejuar apo të ndaluar eksportin apo importin e produktit të kripës së pajodizuar dhe të ushqimeve. Për këtë ne propozojmë të hiqet kjo shprehje, pasi, në raste të tilla, vetë vendet, ku shkon një produkt i tillë, i cili nuk përmbush kriteret e përcaktuara në legjislacionin e tyre, e rikthejnë mallin në origjinë. Pra, strukturat shtetërore doganore e kanë

të pamundur të verifikojnë se cilat shtete e lejojnë apo e ndalojnë eksportin e kripës së pajodizuar. Në këtë këndvështrim Autoriteti Doganor do të vendoset në një situatë juridike, të cilën nuk ka mundësi konkrete për ta zbatuar këtë dispozitë. Sugjeroj që paragrafi i dispozitës së nenit 3 të rishikohet nga komisioni, duke e hequr, pasi edhe norma juridike e legjislacionit doganor të Organizatës Botërore të Doganave njih procedurat e rikthimit të mallit në origjinë, pikërisht për standardet që legjislacioni i shtetit, ku produkti shkon për import, e ndalon ose e lejon, siç ndodh edhe në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, kemi propozuar se në rast se merren në konsideratë propozimet e autoritetit doganor, duhet të shtrihen edhe efektet në nenet 9 dhe 10 të ligjit nr. 9942, në të cilin përcaktohen ndalesat ligjore të përdorimit të kripës së pajodizuar dhe kriteret e tyre për hedhjen në treg të kripës së jodizuar. Në rast se komisioni do të vendosë të marrë në konsideratë propozimet e autoritetit doganor dhe të ministrisë, në nenin 9 duhet të shtohet fjalja: “Përveç rasteve të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji”, që të shtrihen këto efekte, sepse ka papërputhshmëri dispozitash në ligjin nr. 9942, si në nenin 9, edhe në nenin 10.

Në pikën 1 të nenit 12 paragrafi i parë, që është neni pestë i projektligjit, ku thuhet: “Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor”, vlerësojmë të shtojmë paragrafin “Në përputhje me parashikimet në legjislacionin doganor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është neni 5 i projektligjit, i cili...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është fjalja e dytë dhe thuhet: “Ky kontroll realizohet nga autoriteti doganor” dhe propozojmë të shtojmë: “Në përputhje me parashikimet në legjislacionin doganor”. Pika 5, sërish e propozuar në vijim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ju kërkoj ndjesë, ndërsa pas presjes ku thuhet: “Drejtoritë rajonale dhe vendore të shëndetësisë dhe inspektorati që mbulon fushën e shëndetësisë...”, duhen shtuar fjalët: “Dhe për verifikimin e nivelit të jodit në kripën e jodizuar të importit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht në pjesën e gjurmueshmërisë. Pra, jo vetëm të gjurmueshmërisë nga pikëpamja dokumentare, por edhe marrjen e mostrës, analizimin e saj deri në përcaktimin e përqindjes së jodit të kësaj kripe, sepse autoriteti doganor nuk analizon përqindjen e jodit. Ne vërtet kemi laborator doganor, por qëllimi i këtij laborator ka të bëjë më së shumti me përshkrimin tregtar të produktit që importohet dhe për klasifikimin tarifor të tij. Ndërsa Inspektorati Shëndetësor Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare e Ushqimit kanë laboratorët e tyre,

të cilët përcaktojnë në parametra teknikë cilësinë e produktit dhe certifikojnë në mënyrë përfundimtare produktin nëse është për konsum njerëzor ose jo.

Në konkluzion të certifikatës së analizës nga këto autoritete shtetërore është vetëm autoriteti doganor, i cili procedon me procedurë doganore për ta kaluar mallin ose për ta kthyer në origjinë, në rast se nuk i plotëson kriteret. Në fakt, në shkresën që ne i kemi paraqitur komisionit kemi ngritur edhe shqetësimin lidhur me kripën që vjen nga guri i Himalajeve, por jemi rezervuar për ta trajtuar si propozim për ndryshime ligjore, pasi vlerësojmë se për këtë propozim duhet të shprehet Ministria e Shëndetësisë lidhur me lejimin ose jo të importit të kripës së Himalajeve. Prandaj, këtë element nuk e kemi propozuar për ndryshim ligjor. Këto janë propozimet e degës doganore të analizuara nga ana jonë.

Faleminderit për vëmendjen!

Hari Lena – I nderuar kryetar,

Siç e thatë edhe ju, të gjithë jemi të interesuar për mbarëvajtjen e shëndetit të popullatës në Shqipëri. Problemi i jodizimit të kripës është një problem mbarëbotëror. Në vitin 1992, siç e përmendët edhe ju, me mbështetjen e UNICEF-it, u bë një punë madhe për kontrollin dhe kujdesin e jetës së popullatës për sa u përket problemeve të fytit apo problemeve mendore nga mungesa e jodit në kripë. Nga viti 1993 unë jam marrë personalisht me problemin e kripës dhe e kam mbështetur të gjithë iniciativën e UNICEF-it. Unë kam 30 vjet, që merrem me problemin e kripës në Shqipëri dhe, si kompani, i kemi mbështetur studimet e veçanta që ka bërë UNICEF-i në atë periudhë. Madje, ne kemi bërë fushata medietike me profesorë se çfarë pasojash krijonte mungesa e jodit në Shqipëri. Ne kemi bërë edhe studime për këtë çështje, si dhe një libër lidhur me problemet e mungesës së jodit. Sot marr shkas (duke përjashtuar faktin se jam një tregtar dhe importues i produktit të kripës dhe ka mbi 10 vjet që jam edhe investitor në qytetin e Durrësit, ku kam ndërtuar një nga fabrikat më të mira në Ballkan) të shpreh se është nevojshme përmirësimi i legjislacionit dhe i të gjitha procedurave të ndjekjes apo kontrollit lidhur me produktin e kripës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër! Ne kemi 10 vjet që kemi bërë një nga investimet më të mira në Ballkan, ku, përveç fortifikimit bëjmë edhe pastrimin e kripës me standarde shumë të mira. Ajo që ne kemi vënë re kohët e fundit, se këtu u fol shumë për rëndësinë që ka kripa e jodizuar për konsumatorin dhe për familjen, është se baza ligjore lidhur me kontrollin e këtij produkti duhet të jetë më e fortë. Ky kontroll nuk duhet të jetë vetëm për prodhuesin, por duhet të shtrihet tek të gjitha njësitë, sado të vogla qofshin këto njësi. Në qoftë se ky kontroll nuk bëhet në çdo njësi, pra nëse do të gjendet produkt i pajodizuar në produktet e konsumit familjar, atëherë kjo gjë

duhet përcaktuar më mirë në ligj. Në qoftë se ne duam vërtet ta mbrojmë popullatën nga mungesa e jodit në Shqipëri, atëherë mund të them se ky ligj ka jashtëzakonisht shumë mangësi. Unë këtë ligj kam kohë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimet tona i kemi bërë, por, së pari, është mbrojtja e popullatës. Pra, që të mbrosh popullatën, duhet të vendosësh kushte dhe rregulla në ligj për këdo aktor që do të merret me këtë punë. Pra, edhe njësia më e vogël duhet të mbajë përgjegjësi nëse tregton një produkt që nuk ka jod ose nëse kripa është e pajodizuar. Për sa i përket tregtimit të produkteve të kripës industriale, nuk janë në përgjegjësinë e supermarketeve, minimarketeve apo njësive fundore që t'i tregtojnë, por janë në përgjegjësi të operatorëve të fabrikave, siç e tha edhe zotëria i doganave. Kripa është një produkt që futet jashtëzakonisht shumë në industri dhe nuk duhet të largohemi nga legjislacioni europian. Përderisa ne duam të hyjmë në Europë, përderisa duam të aderojmë dhe të jemi të mirë në bërjen e ligjeve dhe në përshtatjen e tyre, ne nuk duhet të bëhemi pengesë për futjen e produktit të kripës si lëndë e parë, por duhet ta kemi nën kontroll. Pra, duhet të jenë kompani të licencuara ato që duhet të kontrollojnë dhe lejojnë futjen e produktit të kripës në Shqipëri. Pa diskutim që jodi nuk merret vetëm nëpërmjet gatimit nga kripa që konsumojnë familjet, por merret edhe nëpërmjet produkteve të tjera. Të gjithë ata, që kanë industri të prodhimit, të fortifikimit ose të pasurimit të produktit të kripës, ndeshen me një absurditet, sepse kripa, kur prodhohet, kur pastrohet, kur përpunohet dhe kur ambalazhohet, ka nënprodukt të saj fraksionimin.

Fraksionimi më i vogël është te kripa e konsumit familjar, sepse e ka jodin shumë herë më të madh. Nënprodukti i kripës, që del me fraksionim më të madh, gjë të cilën jua kam sqaruar, përmban një sasi më të vogël jodi. Kjo është mënyra e procesit në çdo vend të Komitetit Europian, por edhe të rajonit. Standardizimi i kripës dhe fortifikimi i saj për konsum njerëzor e ka gjithmonë më të lartë; për konsum industrial e ka më të ulët dhe për konsum shtazor e ka edhe më të ulët, sepse vetë industria e prodhimit të saj me këtë procedon. Ne duhet të ndërhyjmë në mënyrë që ta standardizojmë, në mënyrë që të nesër të mos ketë abuzime. Pra, për konsum njerëzor prodhimi i kripës duhet të jodizohet dhe të fortifikohet nga 30 deri në 50 ppm; për prodhim industrial kripa duhet të fortifikohet nga 15 deri 25 ppm, që shumë vende në botë e kanë për konsum njerëzor këtë sasi ppm-i; si dhe për konsum shtazor fortifikimi duhet të jetë nga 12 deri në 15 ppm. Kjo duhet të bëhet në mënyrë që të jemi korrektë dhe që nesër të mos lemë rrugë abuzive. Duhet të dini edhe një gjë: ka shumë kontrolle abuzive dhe shumë gjëra bëhen për qëllime të këqija. Ky është një nga shqetësimet që ne kemi ngritur.

Gjithashtu, çdo ditë ne ndeshemi me datat e skadencës së produkteve. Duhet të kuptojmë se jodi që ne përdorim, i cili vjen nga Brukseli, nga Komiteti European, e ka datën e skadencës 3-vjeçare. Pothuajse në mbarë Europën data e skadencës është 3-vjeçare, madje mund t'ju them që ne kemi kripë 4-5 vjeçare, që është e fortifikuar nga 40 deri në 50 ppm, sepse mbahet sipas kushteve dhe rregullave që kërkohen, larg dritës, larg diellit e të tjera. Në qoftë se flasim për jodurin, kuptohet që joduri ka skadencë 1-vjeçare. Meqenëse për mua është hera e parë që ndodhem në një tavolinë të tillë të komisionit, sepse takime të veçanta kam pasur me UNICEF-in, dhe, meqenëse është marrë kjo iniciativë për të përmirësuar këtë ligj, ne duhet të gjejmë rrugët e duhura, në mënyrë që gjërat të mos mbeten evazive. Kjo bëhet për arsye sepse edhe operatorët, edhe bizneset, edhe prodhuesit kanë nevojë të gjenerojmë mirë këto gjëra, pasi ne jemi prodhues dhe duam të eksportojmë. Çfarë duhet të bëjmë ne me produktin që del nga nënprodukti i kripës që përdoret për konsum njerëzor, të cilin ne e nxjerrim me fortifikim nga 45 deri në 50 ppm? Kjo kripë është e pamundur të riciklohet dhe të jodizohet përsëri me këtë masë fortifikimi. Kjo është marrëzi dhe nuk ka ndodhur në asnjë vend, prandaj mendoj se duhet parë legjislacioni. Për shembull, Serbia dhe Maqedonia e kanë 12 deri në 18 ppm-në për konsum njerëzor, kurse për produktet shtazore e kanë 12 e ca...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

OBSH –ja e ka nga 20 deri në 60 ppm-në, kurse Serbia më duket se e ka nga 12 deri 24 ppm-në; për produktet njerëzore e ka nga 18 deri në 24; për produktet shtazore e ka nga 12 deri në 18, gjithashtu, ka edhe disa lloje të tjera jodizimesh.

Gjithashtu, nuk duhet të ndalohet tregtimi nga rajoni. Ne duhet të kontrollojmë, por nuk duhet të ndalojmë tregtimin e kripës së pajodizuar nga operatorët tanë industrialë. Kripa e pajodizuar përdoret për rrugët, për prodhimin e lëkurës dhe për shumë gjëra të tjera në industrinë ushqimore, si: për konserva, për turshi e të tjera, për filtrimin e ujit. Pra, kjo gjë nuk duhet të ndalohet, por nuk duhet të bëhet rrugë për abuzime. Zotërinjtë që e marrin kripën nga ne, nëse kanë dyshime, duhet ta kontrollojnë, por jo ta ndalojnë.

Gjithashtu, ne kemi kripën e Himalejeve ose kripëra të tjera të veçanta, që jemi përballur pothuajse prej një viti. E rëndësishme është që ky problem të zgjidhet njëherë e mirë, ne jemi ndeshur me këto padrejtësi që na bëhen, por më mirë vonë se kurrë. Tani ka ardhur momenti që këto gjëra të zgjidhen. Kështu që ne propozimet tona ia kemi dhënë edhe me shkrim komisionit.

Unë kam bërë takime me ministren e Shëndetësisë, si dhe me zëvendësministren, por ende nuk kemi gjetur mirëkuptimin. Këtu duhej të ishte edhe ministri Shalsi, sepse kjo çështje ka shumë rëndësi për industrinë e prodhimit, në mënyrë që edhe ne të mos përballemi me këto

vështirësi. Në qoftë se ne do të bëjmë ndërhyrje vetëm për lejimin dhe nuk do të bëjmë ndërhyrje për kontrollin, dhe për ata që e blejnë kripën te prodhuesi, atëherë këta duhet të mbajnë përgjegjësi. Pra, ata që e tregtojnë këtë produkt në market, jo ata që e prodhojnë, duhet të mbajnë përgjegjësi, sepse duhet ta kontrollojnë mallin më parë. Unë, personalisht, u jap tregtarëve fletëanalzën për gjithçka dhe jam në kontroll nonstop. Pra, janë disa gjëra që ne duhet t'i shikojmë njëherë e mirë, përndryshe ligji do të vazhdojë të ketë mangësi. Ligji aktual është jashtëzakonisht shumë i keq dhe kjo është mundësia jonë që ta përmirësojmë në tërësi. Pra, më mirë që të vonohet dhe ta përmirësojmë se sa ta lemë kështu siç është.

Enver Roshi – Faleminderit!

Unë këtu kam një listë të bërë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, ku është provuar shkencërisht se të gjitha ushqimet, që ne konsumojnë, janë me kripë të jodizuar. Pra, fjala që ka ushqime se ekzistojnë ushqime që nuk përmbajnë kripë të jodizur nuk është e bazuar në këtë kërkimin shkencor të OBSH-së që kemi këtu. Unë dua që të më mbështesni të gjithë në këtë aspekt, sepse, në qoftë se do të lemë një shteg sado të vogël duhet të jemi të vetëdijshëm se në terrenin shqiptar kjo do të marrë trajtën e një kaskade dhe në fund do të përfundojmë në një hiç. Ne kemi të bëjmë me një problem shumë të madh për sa i përket shëndetit publik në Shqipëri, që ka të bëjë me të ardhmen e fëmijëve tanë. Unë këtë shqetësim e ngre shumë seriozisht dhe u bëj thirrje edhe industrive që të reflektojnë lidhur me këtë aspekt. Gjurmët e kripës së jodizuar natyrshëm që do të përcaktohen edhe në ligj, por duhet të ndiqet që nga importi deri në konsumin këtu në tavolinë. Pra, edhe një herë e them se nuk ka ushqime ku të mos përdoret kripa e jodizuar, të gjitha ushqimet kanë kripë të jodizuar. Kam listën këtu. Nga OBSH-ja...

Hari Lena - Me fal!

Zoti kryetar, ka një problem të madh. Si prodhues, ju ftoj nesër të vini dhe ta kuptoni. Nuk mund të themi që kripa e jodizuar për konsum njerëzor, se 20 -30 ppm duhet të jetë në dollap, 40 - 60 ppm duhet të jetë te prodhuesi në industri që e pasuron, por nuk mund të jetë kripa industriale në këto nivele. Atëherë, ose nuk e keni studiuar ose nuk e kuptoni. Kripa industriale duhet të jetë shumë herë më pak e jodizuar. Nuk mund të ndalojmë kripën joindustriale, ajo duhet për lëkurën, për rrugët, për ujin, i cili nuk do jod. Po të vish sot, të shikosh se kush ka marrë në kompani, se kush ka bërë blerje, janë fare të thjeshta. Ne bëjmë sikur po bëhet çudia, por janë shumë të thjeshta për të kapur këdo që abuzon me këtë gjë, është minimalja . Po të vini dhe t'i shikoni sot kanë blerë 10 vetë. Unë kam blerë 10 tonë kripë. Ku e kam përdorur?! Kontrolli e ka fare të thjeshtë se çfarë bën kushdo dhe për çfarëdolloj gjëje. Tani është shansi, sepse ne do të mbetemi përsëri me një ligj të çalët. Skandal

nëse ne nuk ndajmë kripën ushqimore për konsum njerëzor dhe kripën industriale të jodizuar për prodhim produktesh ushqimore. Është fare e thjeshtë që ta përcaktojmë. E bën të bardhën mbi të zezë, e qartëson, për këtë gjë duhet kripë e jodizuar dhe për të gjithë industrinë ushqimore dhe kripë e jodizuar për industrinë, por përgjegjësia për produktet që blen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mira Rakacolli - Qëllimi i këtij ligji që po diskutojmë është pikërisht se këto ndryshimet që bëhen janë të destinuara vetëm për kripën që përdoret në industrinë ushqimore, pra nuk e prekin këtë gjë. Neni 1, qëllimi i ligjit, thotë shprehimisht: “Ky ligj ka për qëllim parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut nëpërmjet jodizimit të përgjithshëm të kripës së destinuar për konsum njerëzor, shtazor dhe për përdorim në industrinë ushqimore”. Problemi i lëkurës e të tjerat nuk preken, nuk janë objekt i këtij ligji. Janë vetëm masat që merren për kripën për konsumin human dhe shtazor.

Ilir Pendavinji - Propozoj që t’i dëgjojmë të gjithë të ftuarit njëherë, pastaj të hyjmë në këtë diskutim, sepse kështu hyjmë dhe nuk dalim dot nga i gjithë qerthulli i bisedës.

Enver Roshi - Po patjetër!

Jolanda Hyska - Jam shefe Sektori e Sigurisë Ushqimore dhe Ushqyerjes në Institutin e Shëndetit Publik prej 20 vjetësh. Në fakt, Instituti i Shëndetit Publik nuk është njohur me komentet e fundit që paraqitën si përfaqësuesit e Drejtorisë së Doganave, ashtu edhe zoti Hari Lena.

Për projektligjin që na është sjellë për koment, Instituti i Shëndetit Publik ka kthyer përgjigje vetëm në lidhje me pikën për sa i takon nenit 3, paragrafi i dytë për t’u lejuar përdorimi i kripës së pajodizuar. Jam e përfshirë në studimet e deficiencës jodike në popullatë që në vitin 2002 dhe jam koordinatore kombëtare e 3 studimeve kombëtare dhe e një bashkëpunimi ndërkombëtar të zbatuar deri sot në vendin tonë.

Për sa u përket problemeve të shëndetit publik dhe të efekteve në shëndetin e popullatës ISHP-ja ka qenë një *background* shumë i mirë i të dhënave që ka ofruar për sa i përket ndryshueshmërisë ligjore që ka pësuar që nga hera e parë në vitin 1997, kur ka dalë VKM-ja e parë për përdorimin e kripës së jodizuar vetëm si kripë tavoline, pastaj me ligjin në vitin 2008 dhe sot me rishikimin e tij.

Kemi qenë pjesë e procesit që nga momenti i diskutimit për të forcuar këtë ligj. Dy kanë qenë objektivat kryesore të grupit të punës, ka qenë ajo që me të drejtë e theksuan kolegët, që të rritet, të forcohet sistemi i kontrollit, sepse pika më e dobët që ne kemi parë gjatë zbatimit të ligjit ka qenë sistemi i kontrollit. Duke marrë parasysh se ka pasur edhe disa ndryshime për sa i përket organizimit të institucioneve, kjo gjë bëhej edhe më e domosdoshme për të saktësuar

edhe kompetencat e gjithsecilit institucion, sepse vihej re që kishte mbivendosje, kishte raste që gjërat mbeteshin të pambuluara.

Një element shumë i rëndësishëm që i shtohet propozimit të projektligjit është edhe gjurmueshmëria. Me të drejtë unë mbështes edhe zotërinjtë që folën pak më parë, pasi është një nga pikat më të rëndësishme për të bërë të mundur që kripa e jodizuar për konsum human dhe shtazor të ofrohet 100% në popullatën shqiptare. Për fat të keq, sikurse e tha dhe profesor Roshi, konsumi i kripës së jodizuar është 62%, që do të thotë 60,2 % e popullatës përdorin sot kripë, gati 40 %, 2 në 5 shqiptarë kanë ende akses për jod.

Më lejoni t'ju them, është diçka teknike, por do të na ndihmojë për diskutimet e mëtejshme, ne kemi qenë një vend me deficiencë të rëndë jodike, 98% e popullsisë shqiptare në vitin 1993 ishte me deficiencë jodike, nga e cila 63% një shifër shumë e lartë ishte deficiencë e rëndë, që do të thotë se nëse jemi në nivelet e deficiencës së rëndë në atë periudhë do të thotë se kemi pasur një përqindje të lartë të fëmijëve, gjë e papranueshme me kretimizëm, me strumë, që është maja e ajksbergut për problemet e deficiencës jodike, por për fat të keq në popullsinë shqiptare kanë qenë shumë të larta.

Kur është futur për herë të parë programi i përdorimit të kripës së jodizuar ka qenë shumë frytdhënës ashtu sikurse edhe propozohet nga OBSH-ja, UNICEF-i, Komiteti Ndërkombëtar për Parandalimin dhe Kontrollin e Deficiencës Jodike, që përdorimi i kripë së jodizuar është një nga mjetet më efektive për të parandaluar apo për të ulur deficiencën jodike. Studimi i vitit 2006 na çoi nga 98% në 56%, një shifër mbresëlënëse. Përveç kësaj më optimist ishte fakti se nga 62% deficiencë e rëndë, ishte vetëm 6.8, pra 10 herë u ul deficiencia e rëndë. Kjo na bëri të analizonin se çfarë mund të behej më tej që të përmirësohej situata. Nga një VKM, ka dalë ligji i vitit 2008, u bë ligji i përdorimit universal të kripës së jodizuar. Në vitin 2010 kemi pasur dy studime, në vitin 2012 kemi pasur një studim kombëtar. Çfarë ndodhi? Nga 56% ne sot jemi 50%, që do të thotë gati pas 7-8 vjetësh të ligjit diferenca e përmirësimit është shumë e vogël, ndërkohë që ne kishim si objektiv që ta çrrënjoshim, që do të thotë se popullata shqiptare pas futjes së jodizimit universal të mos kishte më probleme, por vëmë re se nga vitet 2008-2010, 2012 dhe sot me DHS-in ne shkojmë nga 75% në 65%-62% kripë të jodizuar që do të thotë se ligji është relativisht i mirë, por për sa kohë që ne kemi akoma në treg, u vu re se nuk kishte më problem as i promocionit, sepse ka pasur edhe fushata promociionale edukimi nëpër shkolla, me nënat, me grupet e specialistëve të shëndetit publik, por edhe me grupet e interesit, ka pasur shumë trajnime, takime edhe biseda dhe shumë materiale promovuese edhe me Këshillin e Agrobiznesit. Ne kemi bërë shumë takime, kemi ofruar materiale. Përveç të tjerave dua të theksoj se ka një ngurrim shumë të madh për sa i

përket kripës së jodizuar në industrinë ushqimore, veçanërisht bulmeti, industria e përpunimit të ushqimeve, tradita jonë për turshinë, me idenë që kripa e jodizuar e prish produktin. Ne kemi sjellë një evidencë shkencore ndërkombëtare, që nga akullorja në Itali, Zvicër apo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...kjo ka qenë tendenca që të përdornim kripë të jodizuar dhe trashmë kemi përgatitur broshura dhe referenca ku të gjithë të interesuarit mund të konsultohen.

Nga e gjithë analiza që është bërë ne menduam se pika më e dobët për sa kohë kemi ende kripë të pajodizuar në treg është pikërisht kjo, sepse kontrolli, inspektimi apo monitorimi nuk ka funksionuar ashtu siç duhet. Në kuadër të kësaj, grupi i punës i ngritur në Ministrinë e Shëndetësisë i ka marrë në konsideratë këto mangësi dhe solli këtë projektpropozim.

Nëse do të më lejoni, do të vazhdoj edhe me pjesën e komenteve të kolegëve për sa i përket kripës së Himalajës.

Ne kemi qenë gjithë kohën nën presionin e tregtarëve për ta lejuar. Me shumë të drejtë zoti Hari Lena tha se ka nivele të ndryshme të jodizimit, por kini parasysh se historia e përcaktimit të niveleve të jodizimit është histori kombëtare, në kuptimin që në varësi të deficiencës jodike përcaktohet niveli i jodizimit, OBSH-ja thotë 20-60 ppm. Me të drejtë Maqedonia e ka 15-20 ppm, por Maqedonia për fat të mirë është një vend që e ka çrrënjësuar dhe ata tani janë në nivelet e ruajtjes, që të mos kenë probleme të kthimit mbrapa ruajnë këto nivele, ndërsa nivelet tona janë nivele të bazuara në deficiencën së pari, në nivelet brenda *range*-it që OBSH-ja jep, që do të thotë se propozimi që vjen nga Doganat që të shtohet, që të kihet parasysh kripa e pajodizuar për sa u përket elementeve shëndetësore, kam përshtypjen për të mos thënë se jam i bindur, se Komiteti Kombëtar i Deficiencës Jodike ka marrë në konsideratë këtë fakt, sepse studimet tona tregojnë se ne nuk kemi probleme të jodit në nivele shumë të larta në urinë, që do të thotë se ne nuk kemi risk për sëmundjet e hipertirozës ose tirotoksikozës, që janë sëmundje që vijnë si pasojë e marrjes së niveleve të larta të jodit.

Niveli që thotë OBSH-ja si risk është mbi 400 mikro gram, ne nuk kemi në popullsinë tonë nivele të tilla. Ne themi se niveli 40-60 është i mbrojtur edhe për sa u përket problemeve shëndetësore.

Kam një koment tjetër për kripën e Himalajës, sot ka shumë teori se kripa e Himalajës mbart vlera nutricionalë të veçanta në raport me kripën e zakonshme të detit apo të gurit që ne përdorim. Nëse do t'i referohemi evidencës shkencore diferenca midis kripës së Himalajës, e cila del nga minierat e Pakistanit, sepse pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se vjen nga malet e Himalajës, është e vërtetë se ka elemente në nivele më të larta minerale, siç është kalciumi, kaliumi, magneziumi dhe hekuri, sesa kripa e gurit apo e detit, por sasia e konsumit

të kripës dhe nivelet që përmbahen në këtë kripë nuk sigurojnë benefite shëndetësore, sepse këto elemente në marrin edhe nga burime të tjera ushqimore, plus që konsumi i kripës është i tillë që këto nivele nuk sjellin përfitime shëndetësore. Pra, duke pasur parasysh se kemi një situatë ende vulnerabël për deficiencë jodike, mendoj se mund t'ia heqim luksin vetes për përdorimin e kripës së Himalajës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi - Të dëgjojmë përfaqësuesit e UNICEF-it, zonja Bukli.

Mariana Bukli - Faleminderit, profesor Roshi!

Jam përgjegjëse e programit të shëndetësisë në zyrën e UNICEF-it.

Dua t'ju falënderoj për ftesën që na keni bërë për të dhënë opinionin tonë në lidhje me këtë diskutim dhe këtë projektligj!

Zyra e UNICEF-it ka shumë vite që është partnere e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Institutit të Shëndetit Publik në programet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të fëmijës, specifikisht në programin e luftës kundër pamjaftueshmërisë jodike.

Në lidhje me projektligjin që kemi në diskutim, propozimet tona janë :

Në nenin 3 të projektligjit, në paragrafin e parë aty ku thuhet: “Lejohet importi i kripës ushqimore të pajodizuar vetëm për qëllimin e fortifikimit të kripës me jod nga subjektet e licencuara për këtë qëllim sipas legjislacionit në fuqi për licencimin”, ne sugjerojmë që të shtohen fjalët: “Dhe duke garantuar gjurmueshmërinë e jodizimit të kripës”.

Në ndryshim nga ligji ekzistues ky projektligj lejon importimin e kripës ushqimore të pajodizuar në vend me qëllim jodizimin. Ne e kuptojmë se ky ndryshim merr parasysh edhe ndryshimet në tregun shqiptar, kapacitetin më të madh që ka aktualisht vendi për prodhimin në vend të kripës së jodizuar, por nga ana tjetër duam të theksojmë se është shumë e rëndësishme që gjurmueshmëria e këtij produkti, e kripës që hyn si e pajodizuar për t'u jodizuar në vend i gjithë procesi të jetë shumë i rreptë, sepse nuk do të donim që një kripë e pajodizuar të përfundojë në treg ashtu siç është në fakt dhe të mos arrijë të jodizohet.

Në lidhje me të njëjtin nen, me nenin 3 të projektligjit në diskutim, ku thuhet : “Lejohet përdorimi i kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve, përgatitja e të cilave parashikon domosdoshmëri përdorimin e kripës së pajodizuar. Këto ushqime përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për Shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për Ushqimin”. Opinioni i Zyrës së UNICEF-it është që ky paragraf duhet të hiqet, pasi nuk gjendet në asnjë referencë shkencore ekzistuese, qoftë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, qoftë të UNICEF-it, qoftë të FAO-s një listë ushqimesh që kërkojnë domosdoshmëri përdorimin e kripës së pajodizuar, nuk ekziston një listë e tillë, përkundrazi standardet dhe referencat

shkencore ndërkombëtare janë që përdorimi i kripës së jodizuar edhe në industrinë ushqimore nuk i dëmton vetitë organoleptike të ushqimeve. Vjet në tetor, pikërisht në kohën e duhur për diskutimin tonë, në botimin për programin e parandalimit të deficiencës jodike, që është Rrejt i Ndërkombëtar i Jodit, ku edhe OBSH-ja, edhe UNICEF-i janë partner në këtë rrjet, është bërë një studim dhe një botim në revistën ndërkombëtare të teknologjisë së ushqimit: *Journal of Food Science and Technology* në korrik të vitit 2018, ku thuhet se asnjë nga grupet ushqimore që janë marrë në studim nuk është parë se janë afektuar nga përdorimi i kripës së jodizuar (është një studim i qartë), duke filluar që nga salcat, salca e peshkut, gjërat që përdoren më tepër në vendet aziatike, duke vazhduar me produktet e djathit dhe të bulmetit, me bukën, me produktet e përpunuara të mishit, të sallamit, duke vazhduar me produktet e detit, duke vazhduar pastaj me turshitë e me konservat. Pra, nuk ka asnjë ndryshim organoleptik, është revista ndërkombëtare e teknologjisë së ushqimit.

Nga ana tjetër, do të doja të theksoja se përdorimi i kripës së jodizuar ndihmon në përmirësimin e shëndetit të konsumatorit. Shqipëria është në një situatë deficiente jodike. Për arsye madhore të shëndetit publik jemi të detyruar të propozojmë një ligj të tillë, që krijon disa kufizime, por siç e tha profesor Roshi: a jemi ne gati që, për hir të mbrojtjes së disa interesave të industrisë ushqimore, që me të drejtë mund të prononcohen në këtë mënyrë, të pranojmë që në Shqipëri të lindin fëmijë të tillë, me prapambetje mendore, me paraliza, që përveç problematikës që krijojnë në familje e në shoqëri, janë edhe një barrë ekonomike shumë e madhe? Më falni, nuk dua ta them këtë gjë, se për mjekët, për UNICEF-in, ana humane vjen në radhë të parë, por gjithsesi, meqë kemi edhe kolegë, e në fund të fundit edhe zgjedhjet që bën qeveria e parlamenti për të marrë një opsion apo një tjetër, përcaktohen edhe nga kostot ekonomike. Në fakt, nuk duhet të jemi gati të pranojmë fëmijë të tillë.

Gjithashtu, në paragrafin e tretë të nenit 3: Lejohet eksporti i kripës së parodizuar....”, flasim gjithnjë për ligjin që kemi në diskutim, është paragrafi i fundit: “Lejohet eksporti i kripës së pajodizuar dhe i ushqimeve të prodhuara me kripë të pajodizuar në vende ku nuk ekziston ndalimi i kripës së pajodizuar”.

Ne sugjerojmë të shtohet, duke garantuar gjurmueshmërinë në procesin e eksportit. Gjithashtu, argumenti është i njëjtë si më sipër. Është shumë e rëndësishme të garantojmë që ato produkte që themi se janë me kripë të pajodizuar e do të shkojnë për eksport, të shkojnë vërtet për eksport dhe të mos përfundojnë në tregun shqiptar.

Komenti i fundit që kemi ne si zyrë e UNICEF-it: në nenin 13/2, që lidhet me gjurmueshmërinë. Sipas mendimit tonë, është një shtesë shumë e mirë që i është bërë këtij projektligji, por megjithatë mungon qartësia lidhur me rolin konkret e aktiv që duhet të ketë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përcaktimin e standardeve të gjurmueshmërisë, gjithashtu dhe institucionet e varësisë, të cilat janë AKU-ja dhe Inspektoriati i Shëndetësor Shtetëror.

Sugjerohet që këto hallka të gjurmueshmërisë ose të përcaktohen më mirë në këtë ligj, ose nëpërmjet akteve të tjera normative, si një vendim i Këshillit të Ministrave.

Unë dua t'ju falënderoj edhe një herë për mundësinë që na dhatë që të paraqisnim shqetësimet e komentet tona, si dhe t'ju siguroj se UNICEF-i do të vazhdojë të mbështesë Ministrinë e Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik në procesin e zbatimit të ligjit, deri sa të arrijmë të gjithë së bashku aty ku duam të arrijmë: eliminimin e pamjaftueshmërisë jodike në Shqipëri.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zonjushë Mariana për ekspertizën shumë shkencore dhe të bazuar në evidencë, të sjellë këtu!

Tani ia jap fjalën zëvendësministres së të Shëndetësisë, Mira Rakacolli, kryetare e Komitetit Kombëtar për Defiçencën Jodike.

Mira Rakacolli – Në fakt, problemi i defiçencës jodike është i mirënjohur nga Ministria e Shëndetësisë, dhe vetë sjellja e ndryshimeve të projektligjit në këtë tavolinë ka ardhur pikërisht ngaqë i di shumë mirë të gjitha ato probleme, që doktoreshë Jolanda i prezantoi me aq kompetencë para të gjithëve.

Iniciatore për ndryshimet në ligj është bërë Ministria e Shëndetësisë. Pikërisht pranë Ministrisë së Shëndetësisë funksionon Komiteti për Eliminimin e Defiçencës Jodike. Anëtarë të këtij komiteti, përveç ekspertëve, përveç njerëzve që janë përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë, ka shumë teknikë, të cilët përfaqësojnë Institutin e Shëndetit Publik, UNICEF-in, Drejtorinë e Doganave, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Financave.

Pra, ndryshimet fillestare janë propozuar pikërisht nga ekspertët që përfaqësojnë edhe problemet e ngritura këtu nga të gjitha grupet e interesit. Pra, ajo që dua të përsëris edhe një herë, është se të gjitha grupet e interesit, këto që janë në tavolinë, e edhe të tjerë, kanë përfaqësuesit e tyre në këtë komitet.

Nga ana tjetër, mbasi janë propozuar ndryshimet, ligji ka kaluar atë procesin e zakonshëm që kalon ligji për të gjitha ministritë e linjës, nga Ministria e Financave e kemi pasur dakordësinë pa ndonjë ndryshim të madh. Kështu që, të them të drejtën, shumë mirë që erdhi, shumë mirë që e dëgjuam, por unë jam pak e surprizuar nga fakti që komentet e Drejtorisë së Doganave vijnë në momentin e fundit, pasi dhe institucioni prej të cilit ata varen, Ministria e Financave, e ka dhënë dakordësinë.

Nuk ka asgjë të keqe, por këto gjëra duhen parë, aq më tepër që edhe në këtë komitet për të cilin unë fola, Drejtoria e Doganave e ka përfaqësuesin e vet, i cili e ka shprehur mendimin në lidhje me këto ndryshime dhe këto gjëra që duhen bërë.

Ne jemi munduar që, nëpërmjet këtij projektligji t'i zgjidhim këto probleme. Natyrisht, ministritë e tjera, si Ministria e Bujqësisë, Ministri për Sipërmarrjen, i kanë sjellë komentet e tyre dhe janë pranuar ndryshimet që janë bërë. natyrisht, ju të gjithë e keni përpara ligjin. I dëgjuam me shumë vëmendje komentet edhe nga grupet e interesit. Tashti më duket sikur është komisioni ai që duhet të shqyrtojë dhe të vendosë se si do të jetë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, profesoreshtë Mira!

Atëherë, fjala për Ministrinë e Bujqësisë, për zonjën Edlira Llënga.

Edlira Llanga – Të nderuar pjesëmarrës,

Unë përfaqësoj këtu Ministrinë e Bujqësisë, sikundër e thatë edhe ju, zoti kryetar. jam drejtore e Drejtorisë së programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të kuadrit rregullator në këtë ministri.

Sikundër e tha edhe zëvendësministria, zonja Mira, kemi qenë pjesë e procesit të konsultimit në lidhje me këtë projektligj.

Me projektligjin që ju ka ardhur sot për shqyrtim jemi parimisht dakord, por duke marrë shkas edhe nga problematikat e ngritura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të cilat përfaqësuesi i saj i tha më parë, ne kërkojmë që ato lejime për të cilat kemi rënë dakord, dhe që gjenden në nenin 3 të projektligjit, të jenë efektive. Meqenëse në nenin 6 të projektligjit ka parashikime lidhur me importin, të merren në konsideratë sugjerimet e Drejtorisë së Doganave, dhe lejimet përkatëse të spostohen te neni 4 i ligjit bazë.

Disa problematika të tjera, le të themi më minore, që i kemi pasur edhe gjatë procesit të konsultimit, kane të bëjnë me faktin se këto lejime, për të cilat ne jemi plotësisht dakord, që janë në projektligjin e propozuar nga Ministria e Shëndetësisë, të qartësohen edhe te nenet e tjera të projektligjit, që sikundër e tha edhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lejimi i përcaktuar te neni 3 i projektligjit të mos ketë ngërçe në parashikime të tjera të neneve 9, 10, apo dhe të masave administrative e sanksioneve të nenit 17 apo 18 të ligjit bazë.

Një problematikë tjetër, që ne ngremë si ministri, është se do të kërkonim që në këtë projektligj, sikundër edhe në gjithë ligjin, të saktësohet nga ana e inspektoriatit përkatës kontrolli i nivelit të jodit, jo të kripës së jodizuar në përgjithësi, sepse, sipas ligjit për ushqimin, kripa është ushqim. AKU-ja është institucioni përgjegjës për kontrollin e ushqimit.

Përveç jodit dhe nivelit të jodit, kripa ka edhe elementë të tjerë, nga papastërtitë e ndryshme që mund të përmbajë, apo edhe substanca të tjera të dëmshme. Sipas ligjit për ushqimin, për këtë është kompetent Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Kështu, për të pasur një zbatim sa më të qartë dhe të mos kemi problematika në terren, problematika që në shumë raste na janë paraqitur edhe nga përfaqësues të biznesit, do të kërkonim që të ishte shumë e qartë kjo ndarje kompetencash, duke e qartësuar që niveli i kripës në jod të kontrollohet e të monitorohet nga inspektoriatet shëndetësore, ndërsa pjesa tjetër nga AKU-ja.

Megjithatë, po të vijojmë edhe këtu, sipas mendimit tonë do të gjendemi në situatën kur për të njëjtin produkt, që është kripa, biznesit t'i vëmë dy kontrole, dy inspektoriate: nga njëra anë AKU, e nga ana tjetër Inspektoriat Shëndetësor. Sipas mendimit tonë, kjo duhet të marrë një zgjidhje më të mirë, që në lidhje me këtë produkt biznesit t'i shkojë vetëm një inspektoriat, që të inspektohen e të kontrollohen, monitorohen siç duhet të gjithë komponentët e këtij ushqimi, që është kripa.

Disa çështje të tjera janë ato që kanë të bëjnë me nenin 12, për shembull, i cili lidhet me kostot e marrjes së mostrave. Ashtu sikurse është në versionin aktual, për mendimin tonë nuk ka parashikime edhe për industrinë tonë vendëse të prodhimit apo të fortifikimit me jod të kripës në vend, pasi këto parashikohen vetëm në import. Domethënë, për subjekte që importojnë kripën e jodizuar në vend.

Së fundi, kemi disa parashikime ose sugjerime në lidhje me gjurmueshmërinë, që këto të përshtaten edhe me legjislacionin ushqimor, i cili i ka shumë të qarta rregullat për gjurmueshmërinë e ushqimeve, sikundër është kripa, në rastin konkret.

Këto janë ato që Ministria e Bujqësisë ka ngritur si shqetësime, e të cilat donte t'i ndante me ju, në këtë seancë.

Enver Roshi – Faleminderit!

Edlira Llanga – Faleminderit!

Enver Roshi – Atëherë, unë desha të të bëj një pyetje, për oponencë, UNICEFI-t dhe Inspektoriatit Shëndetësor, në lidhje me përballjen dhe kontrollin e dy inspektorateve. Ka mendime nga ju të tjerët? Sepse AKU-ja e kontrollon si ushqim, Inspektoriat shëndetësor e kontrollon si përbërje për shëndetin. Këto janë të koordinuara, mendoj unë. Ne nuk mund të vemi atje e t'i bëjmë presion biznesit. Ai thotë se e kontrollon për aspektin ushqimor, ndërsa ky për aspektin shëndetësor. Pra, nuk shoh ndonjë gjë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, më fal...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Vjollca Braho – ...edhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, edhe AKU-ja punojnë në bazë të një programi inspektimi nga Inspektoriatit Qendror. Çdo muaj çojmë programet të cilat ne inspektojmë, me tematika e me subjekte. Është detyrë e Inspektoriatit Qendror, që të bëjë koordinimin midis Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor dhe AKU-së, në mënyrë që, siç e tha edhe zonja, të mos shkojnë dy kontrole. Në qoftë se shkojnë në një subjekt, pjesa e Inspektoriatit të shikojë parametrat e tij sa i përket kripës, ndërsa pjesa e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor të kontrollojë parametrat e jodit, përcaktuar sipas legjislacionit që po diskutojmë.

Sigurisht, është mjaft e rëndësishme edhe pjesa e gjurmimit. Duhet një koordinim akoma më i madh, e dhe pse kemi udhëzime... Mendoj se me hartimin dhe miratimin e këtij projektligji duhet të përcaktohet akoma më mirë pjesa e inspektimit dhe e koordinimit që duhet të ketë, duke filluar që nga Drejtoria e Doganave. Ne duhet të njoftohemi që, në momentin kur vjen në doganë një parti malli, kripe, sepse sipas praktikës vetëm në dy drejtori bëhet lajmërimi nga ana e doganës, ndërsa në drejtoritë e tjera nuk bëhet lajmërimi. Pra, për sistemin e gjurmimit, që është shumë i rëndësishëm.

Mund të them se për vitin 2019 janë kryer 39 inspektime për sa i përket kontrollit dhe inspektimit për kripën e jodizuar, dhe janë vendosur tri masa administrative vetëm për faktin e janë gjetur pjesë e mangësisë së jodit në kripën që tregtohet në supermarkete, që siç e tha edhe Hari Lena, nuk është kontrolluar vetëm pjesa e institucioneve dhe e subjekteve që merren me jonizimin e kripës, por është bërë kontroll në subjekt, aty ku bëhet shitja e kripës për qytetarët. Janë marrë dy masa administrative në këtë rast, dhe një masë administrative për një subjekt, i cili nuk na ka lejuar të bëjmë inspektimin.

Ne kemi pasur një koordinim shumë të mirë nga operatori, sepse monitorimi bëhet nga ana e operatorit një herë në tre muaj. Në rastet kur është bërë pjesa e kontrollit dhe është gjetur mangësi të jodit në kripën që tregtohet, nga ana e inspektoriatit është bërë vendosja e masave administrative.

Mendoj se pas hartimit të këtij projektligji të përcaktohet akoma më mirë, me një udhëzim, se si do të bëhet koordinimi, duke filluar nga dogana, nga operatori që ndjek pjesën e monitorimit për shëndetësinë dhe pjesën e Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor.

Enver Roshi – Të falënderoj shumë, por unë shpreha opinionin tim, se gjurmueshmëria të jetë juaja, Inspektoriatit Sanitar Shëndetësor, kurse pjesa e doganave të jetë e përbashkët me ju. Mendimi im.

Vjollca Braho – Vetëm një udhëzim, dhe ne jemi dakord.

Enver Roshi – Në rregull! Faleminderit!

Jolanda.

Jolanda Hykaj – Faleminderit!

Në fakt, unë doja vetëm të saktësoja nga ana teknike çështjen e përkufizimit të ‘ushqim i sigurt’ dhe kripës së jodizuar në këtë rast.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Bujqësisë thotë me të drejtë se AKU-ja e ka për detyrë, në kuadrin e menaxhimit të riskut, që të bëjë gjithë kontrollin e ushqimeve, po për sa kohë që kemi një ligj të veçantë për kripën e jodizuar, në kuadrin e deficiencës jodike, diferenca është e tillë: nuk flasim më për ushqim të sigurtë, sepse edhe kripa e pajodizuar, nëse analizohet në lidhje me treguesit e vet që janë brenda parametrave, është ushqim i sigurtë.

Problemi është se ne jemi përballë një gjendjeje shëndetësore tashmë të cenuar. Popullata jonë ka mungesë jodi dhe si ndërhyrje është gjetur pikërisht kjo, një ndërhyrje efektive. Sepse le ta kemi parasysh: është çështje e shëndetit publik çdo çështje shëndetësore që tejkalon përmasën e prevalencës 20 %. Kjo do të thotë se, nëse një në pesë individë janë të prekur, kjo është një çështje e shëndetit publik, dhe politikat e ndërhyrjes janë në të gjithë popullatën.

Kjo është diferenca mes asaj që ne duam të specifikojmë mirë: kontrolli që bën AKU-ja dhe kontrolli që bën Inspektoriati. Ne do të ndjekim nivelet e jodit. Realisht, unë nuk do të isha dakord me askënd që do të pranonte që AKU-ja të ishte përgjegjëse për kontrollin e jodit në kripë, sepse, siç e thashë, është një ndërhyrje e cila, për fat të mirë ka zgjedhur ushqimin, kripën për të dhënë efekt, por ne ndjekim gjendjen shëndetësore të popullatës. Ne nuk ndjekim sigurinë e ushqimit. Nëse përdorim kripë të pajodizuar, ku lënda e patretshme, niveli lagështisë apo lëndët toksike janë në rregull, ky nuk është një ushqim i pasigurtë. Kjo është diferenca midis dy kontrolleve.

Prandaj, unë mendoj se Inspektoriati Shëndetësor dhe drejtoritë rajonale shëndetësore, që do të bëjnë monitorimin, janë pikat kyçe. Drejtoria e Doganave, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, patjetër që duhet të na ndihmojnë në lidhje me gjurmueshmërinë. Në qoftë se nuk do të bashkëpunojmë me ta, nuk do të jetë e mundur të kemi sukses.

Në qoftë se do të fusja edhe një element tjetër, gratë shtatzëna, të cilat janë shumë të rëndësishme si grup vulnerabël për sa i përket deficiencës jodike, mund të bëjmë edhe një ndërhyrje tjetër. Ministria e Shëndetësisë ka aprovuar protokollet. Ne japim jod shtesë në shtatzëni, por kjo nuk do të thotë se kontrolli i takon Ministrisë së Shëndetësisë. Është pikërisht gjendja shëndetësore e tillë, e cenuar në rastin tonë, e cila bën që ta mbajmë këtë peshë ne, si shëndetësi. Më vonë, në momentin kur ne do të jemi të çliruar, gjërat edhe mund të ndryshojnë, por tani për tani, që jemi në këtë situatë... Kur ka çështje të shëndetit publik, edhe rregullat e tregtisë së lirë kanë përjashtimet e tyre për të ndërhyrë dhe bërë kufizimet e mundshme.

Në qoftë se do ti referohemi edhe përpjekjeve të fundit të Komunitetit European, ka një përpjekje masive për të bërë unifikimin e ligjshmërisë, për sa i përket defiçencës jodike, e cila edhe në vendet e Komunitetit European po shtohet. Për fat të keq, ato kanë probleme të tjera mes shteteve, që janë karakteristike për shtete të veçanta, të cilat nuk arrijnë dot të bien dakord, ndërsa ne, brenda vendit tonë nuk e kemi këtë problem, ndaj nuk kemi arsye të hasim të tilla vështirësi. Një shembull është historia e Gjermanisë, e cila nuk po bëhet dot për këtë pjesë, për të unifikuar përdorimin universal të kripës së jodizuar, sepse ka probleme me aksidentin e Çernobilit. Niveli i rrezatimit jonizues vazhdon të jetë i lartë në zona të caktuara dhe kjo krijon probleme, kështu që jo të gjithë popullatës mund t'i japësh kripë të jodizuar, të rrisësh nivelet e jodit, sepse kjo gjë krijon efekte të tjera.

Faleminderit!

Enver Roshi – Kalojmë në pyetje.

(Diskutime pa mikrofon)

Oligert Kume – Kisha një pyetje për drejtoreshën sa i përket kuadrit të bashkëpunimit midis Drejtorisë Rajonale, AKU-së dhe ISHT-së, sepse ne këtë e kemi bërë edhe si propozim, për të ndryshuar pikërisht pikën 1 të nenit 12, të paragrafit 1 të nenit 5 të projektligjit ku kemi cituar: “Kontrolli realizohet nga autoriteti doganor në përputhje me parashikimin në legjislacionin doganor dhe strukturat e ISHT-së do të merren thjesht për të verifikuar nivelin e jodit në kripën e jodizuar të importit”.

Pra, e kemi specifikuar, që në momentin që kripa do të vijë nga importi kemi detyrimin ligjor të informojmë në çdo moment ISHT-në dhe përmes analizës, marrjes së mostrës dhe konkluzionit të fletë-analizës vetëm atëherë vepron për çlirim autoriteti doganor.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, do të doja të falënderoja të gjithë pjesëmarrësit në këtë seancë dëgjimore kaq të rëndësishme, përfaqësuesit e ministrisë, zëvendësministren, Hari Lena Group, UNICEF, ISHP dhe Drejtorinë e Prëgjithshme të Doganave!

Në fakt, diskutimin rreth këtij projektligji e kemi filluar shumë kohë më parë, për këtë do të doja të falënderoja në mënyrë të veçantë UNICEF-in që është angazhuar gjatë gjithë kohës për ndryshimet që na kanë ardhur për këtë ligj. Unë jam relatore e këtij projektligji, por sot jam pak konfuze, sepse duke ju dëgjuar të gjithëve më dalin një sërë pyetjesh, prandaj do t'i propozoja kryetarit të komisionit meqenëse janë kaq shumë ndryshime të paktën të na jepet

më shumë kohë për miratimin nën për nën të këtij projektligji, meqenëse e kemi miratuar në parim.

Kam disa pyetje në veçanti, sidomos për ju që diskutuat. Po e filloj me përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave meqenëse ishte i pari që referuat. Ju me të drejtë kërkonin ndryshim në nenin 5, duke kërkuar që përpara se të kalojë sasia e kripës së importuar të keni një certifikatë, e cila tregon sasinë e jodit. Dua të di a krijon kjo gjë vonesë? A mos vallë duhet si në rastin e medikamenteve, kur bëhet importi importuesit të jenë të detyruar që këtë analizë ta kenë të realizuar, të kenë një certifikatë sigurie që kjo sasi e jodit duhet të jetë e tillë dhe, në qoftë se në analiza të rastësishme del që kjo sasi jodi është më e vogël, atëherë të penalizohet importuesi? Në momentin që ju thoni se do ta bllokoni në doganë dhe do të kërkonin certifikatën kjo bëhet pengesë për importuesin dhe për kohën që duhet (nuk e di sa kohë duhet). E para.

E dyta, në momentin që ne bëjmë analizën të subjekti, tek tregtarët me pakicë apo me shumicë, tregtari me pakicë është hallka e fundit, i cili nuk ka asnjë faj, sepse ai do ta marrë mallin dhe nuk e di sesa jod ka kripa e tij, kur ti i shkon për kontroll dhe i thua, ndërkohë që i kanë shkuar edhe 100 kontrole të tjera nga degë të tjera, dua të analizoj jodin. Pse ne mos ta marrim këtë masë më parë? Ne do të shkojmë dhe tek ai tregtar në mënyrë rastësore, por duhet të dimë që ky kontrolli këtu, sepse tregtarët me pakicë që shesin domate dhe kastravecë na ndalojnë dhe na thonë se u ka shkuar AKU-ja dhe u ka vënë gjoba 1 apo 2 milionë pse kastraveci ka pesticide. Çfarë faji ka tregtari me pakicë për këtë gjë?

Unë mendoj se ka disa hallka që ne duhet t'i forcojmë përpara se të arrijmë në hallkën përfundimtare, edhe prodhimet që prodhohen në vend. Për këtë dua të falënderoj zotin Lena për gjitha përpjekjet që ka bërë ndër vite për jodizimin e kripës, sepse ju garantoj që nuk është një proces kaq i thjeshtë, por është një betejë, të cilën duhet ta fitojmë të gjithë bashkë, nuk e bën dot një individ i vetëm, 1 me 5 prevalenca është akoma shumë e lartë.

Nëse ne do ta bëjmë këtë gjë, sepse nuk ka shanse që ajo kripa e importuar që kalon në doganë të kalojë pa certifikatën që kërkojnë përfaqësuesit e doganës, kjo certifikatë duhet të jetë që më përpara. Ai përfaqësuesi i doganës merr një mostër dhe thotë: “Ti do kalosh, por unë do të bëj provën dhe nëse prova nuk rezulton ashtu siç është në certifikatë, atëherë penalizhet importuesi”.

Kam një pyetje, me të drejtë këtu kemi një inspektorat qendror, i cili ka degët e veta sa i takon shëndetësisë dhe pjesës së AKU-së. Ku është laborator i që bën nivelin e jodit, është te Inspektorati i Shëndetësisë apo e bën AKU-ja?

(Diskutime pa mikrofon)

Është te Shëndetësia.

Përderisa është te shëndetësia pse të mos jetë primar Inspektorati Shëndetësor, sepse prapë do të shkojnë dy kontrolle dhe do të bëhemi të lodhshëm...

Unë besoj se përpjekja maksimale duhet të jetë përsëri jona. Shoh një përplasje kompetencash dhe besoj që rëndësinë primare, ashtu sikurse e tha edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Bujqësisë, duhet ta ketë Inspektorati Shëndetësor. Nëse e ndajmë edhe një herë këtë përgjegjësi besoj se edhe niveli i gjurmueshmërisë, të cilin e kërkojmë me të drejtë dhe duhet të jetë shumë i lartë, atëherë eliminojmë këto “hallkat” e ndërmjetme. Sa më pak hallka abuzive aq më e lartë do të jetë efienca e punës sonë.

Dua të falënderoj zonjën Jolanda, e cila është marrë me këtë punë për shumë vite! Ndoshta kjo që dua t’ju kërkoj mund të jetë e ekzagjeruar për vendin tonë. Në një nga kongreset që organizohen kam dëgjuar një përfaqësues që bën studim për një popullatë të caktuar dhe ata kërkonin të ulnin nivelin e natriumit dhe të shtonin nivelin e kaliumit dhe në atë zonë ata nuk lejuan të hynte asnjë lloj kripe tjetër përveç kripës që do ta prodhonte (po supozoj shteti ynë) për këtë numër të caktuar popullate dhe kjo kripë të kishte sasinë e jodit që duam ne.

Këtu dëgjuam vlera të ndryshme 14, 20, por ne duam vlerën që kërkon Shqipëria, për të mos e pasur 1 në 5, por 1 në 2, po e supozoj, sepse është dëshira jonë e madhe për ta çuar prevalencën. A mund të bëjmë ne një studim të vogël në një zonë të caktuar të popullatës dhe ajo zonë të furnizohet vetëm me këtë kripë që ka këtë nivel jodi që duam ne? Vetëm kështu mund të arrijmë të kuptojmë nëse banorët përdorin kripë të pajodizuar apo jo.

E dimë që problemi kryesor qëndron te gratë shtatzëna. Unë e ngrita këtë çështje edhe kur e kaluam ligjin në parim dhe ishte e pranishme edhe ministrja e Shëndetësisë, por është e pamundur edhe për kosto financiare të bëhet analiza e TSA-shit, që tregon nëse niveli është normal apo jo, por edhe t’i japësh jod më tepër një nëne shtatzënë, duke mos ditur sesa është niveli i TSA-shit, kjo më duket pa sens.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, nëse matim jodurinë, ajo është diçka tjetër. Nëse ne e bëjmë këtë gjë tek të gjitha nënat shtatzëna duke matur nivelin e jodurisë, është pak e vështirë, por nëse e bëjmë të detyruar, atëherë kjo do të jetë diçka pozitive. Duke frenuar të dyja hallkat, pjesën e kontrollit që thamë nëpërmjet doganës dhe inspektoratit dhe pjesën e frenimit të rasteve të reja do të jetë ideale, sepse edhe parandalojmë edhe shërojmë.

Nëse kryetari i komisionit është dakord do t’i lutesha edhe një herë të kemi më shumë kohë për t’i parë edhe një herë materialet, edhe në respekt të kësaj seance dëgjimore, e cila m’u duk shumë frytdhënëse.

Faleminderit!

Jolanda Hykaj – Po e filloj me pyetjen e fundit, e cila kishte lidhje me përdorimin e kripës së jodizuar. Vlen të theksoj se përtej ligjit ka edhe disa urdhra të përbashkëta midis Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Financave sa i përket niveleve të jonizimit të kripës dhe se sa duhet të jenë ato në nivel dogane, prodhimi, tregtimi me shumicë dhe pakicë dhe në nivel familje. Vlerat janë të specifikuara dhe të sakta, 40 deri në 60 import-prodhim, 20% në magazinat e shumicës dhe në tregun me pakicë dhe jo më pak 15 miligramë/jod për kripë do të jetë në nivel familje.

Pra, ne i kemi vlerat e lejueshme, reinxhet, se sa duhet të jetë niveli i jodit sipas çdo niveli të prodhimit dhe të tregtimit. Nuk është se nuk ka, pasi dëgjova prej kolegëve që propozohet të futet, por ne tashmë punojmë me reinxhe.

Sa u përket grave shtatzëna, ato janë grupi më vulnerabil, sepse realisht ka probleme sa i takon zhvillimit të fetusit dhe lindjeve. Ne kemi studime siç është ai në nivel kombëtar i vitit 2006 dhe i vitit 2012-2013, por falë edhe mbështetjes së UNICEF-it kemi pasur një studim *sentinel* në zonat me prevalencë të lartë dhe ato kanë qenë zonat qendrore dhe juglindore e Shqipërisë. Ne kemi bërë analizën e nivelit të jodit në urinën e grave shtatzëna, por për fat të keq si në nivelin kombëtar të 2006-s, edhe sot, studimi i fundit i bërë në vitin 2013, tregon se gratë shtatzëna në Shqipëri kanë deficiencë jodi të konsiderueshme. Kjo do të thotë se nëse sot Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë që ky nivel duhet të jetë 150 deri 250 mikrogramë/litër në joduri, ne kemi një mediant tek 80 mikrogramë/litër dhe ne prandaj po u japim të gjitha grave shtatzëna kapsula jodi të miratuara me protokoll dhe i miratuar nga Komiteti i Jodit nga muajin i parë deri në muajin e gjashtë të shtatzënisë dhe dozimi është i tillë që nuk krijon probleme hiperi me nënën, pasi kjo gjë është marrë në konsideratë.

Sa i përket studimit gjithmonë kemi marrë në konsideratë jo vetëm nivelin e jodit në urinë, por u kemi kërkuar nënave dhe grave shtatzëna edhe kripën që përdorin në familje. Kemi parë se ka një korelacion absolut midis nivelit të jodit në urinë të ulët dhe nënave që përdorin kripë të pajodizuar. Prandaj ne vazhdojmë të këmbëngulim për kripën e jonizuar, por për sa kohë që nënat nuk arrijnë dot t'i përmbushin nevojat e tyre vazhdohet t'u jepet edhe jod. Në fakt, kur ka probleme shpesh nga Klinika e Endrokronologjisë e QSUT-së na vijnë nëna, të cilave u kërkohet të bëjnë analiza për të parë nivelet e kripës në urinë, për të kuptuar nëse ka risk që nënë ta marrë apo jo dhe nëse mund të shihet ndonjë problem që mund ta riskojë nënën që nuk e merr. Ne gjithmonë e bëjmë jodurinë dhe ia referojmë klinikës dhe më pastaj klinikistët vendosin nëse kjo nënë është në rregull apo jo për të marrë nivelet e kapsulave të jodit.

Mariana Bukli – Shumë shkurt dua t'i përgjigjem doktoreshë Klodit në lidhje me monitorimit e programeve të luftës kundër pamjaftueshmërisë jodike. Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe UNICEF-i kanë udhëzime të qarta sesi bëhet kjo gjë, studimet e jodurisë bëhen në një periudhë kohore 5 ose 10 vjet, janë studime të shtrenjta dhe nuk mund të bëhen rutinë. Është edhe një indikator tjetër i ndërmjetëm, siç është përdorimi i kripës së jodizuar në familje që të ndihmon për të kuptuar situatën në vazhdimësi. Pra, ka një set indikatorësh që kombinohen për të na dhënë pamjen e qartë të programit, por jo të gjitha matjet mund të bëhen në mënyrë të vazhdueshme, sepse janë të kushtueshme. Nga ana e kostove të benefitit nuk është e leverdishme.

Klodiana Spahiu – Dua të bëj një ndërhyrje të shkurtër. Në fakt, studimet e fundit edhe në rang europian kanë treguar se pavarësisht gjurmueshmërisë së lartë që ato i bëjnë përsëri edhe në këto vende ka shkallë të lartë të mungesës së jodit. Unë besoj se përveç masave që marrim, si dhe fortifikimi i miellit, e cila është një iniciativë shumë e mirë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, do ta përmirësojë patjetër këtë situatë.

Edlira Bode – Ju kërkoj ndjesë, por do t'i kthehem edhe një herë çështjes së dy laboratorëve të analizave. Nëse e kuptova drejt, Inspektorati Shëndetësor Shtetëror kontrollon nivelin e jodit që ka kripa, ndërkohë që AKU-ja kontrollon përbërësit e tjerë në cilësinë e kripës si ushqim. Janë dy laboratorë të ndryshëm, sepse është e pamundur që i njëjti një laborator t'i bëjë të gjitha këto kontrole.

Nëse kripën e kontrollon laboratorit i ISHSH-së për jod dhe laboratorit i AKU-së për gjërat e tjera, është diçka që do ta kemi në vazhdim edhe për gjërat e tjera, siç tha doktoresha edhe për miellin një projektligj, edhe aty do të duhet që këtë kontrollojë ISHSH-ja për jodin dhe AKU-ja për përbërësit e tjerë e kështu me radhë.

A është e mundur që, kur Inspektorati Qendror dërgon për inspektim, sipas grafikut që inspektorati përcakton ose grupin e ISHSH-së apo të AKU-së të i njëjti subjekt, të dërgojë një grup të përbashkët dhe të merret i njëjti kampion dhe të kontrollohet në të dyja laboratorët?

Pyetjen po e bëj edhe për Vjollcën dhe për përfaqësuesin e Ministrisë së Bujqësisë. A mund të jetë e shkruar kjo gjë dhe të ruhet diku, si dhe të jetë e detyruar që, kur merret një kampion kripe të kontrollohet në të dy laboratorët dhe të dorëzohet një certifikatë?

Faleminderit!

Jolanda Hykaj – Sa i përket kontrollit, teknikisht laboratorët e shëndetit publik i bëjnë të gjithë treguesit e analizës së kripës dhe kjo nuk është problem...

(Diskutime pa mikrofon)

AKU-ja ka laboratorët e vet ISUVI, ndërsa Shëndeti Publik ka laboratorët e tij si Institutin e Shëndetit Publik në nivel kombëtar, por edhe drejtoritë e shëndetit publik. Në çdo rreth që ka doganë ka edhe laboratorë që bëjnë analizën me titrim, domethënë përcaktimin sasior të jodit. Të gjitha pikat doganore ku hyn kripa janë të detyruar që në momentin, dua t'ia theksoj edhe dokoreshës, kontrollin në doganë të çdo sasive kripe që hyn e kemi me detyrim me ligj të përcaktojmë sasinë e jodit në laboratorët tanë të shëndetit publik edhe nëse në certifikatë thuhet se sasia e jodit është në rregull, duke u përpjekur që ta ndalojmë direkt aty, sepse po hyri është më e vështirë.

Në doganë ndodhet një nga përfaqësuesit tanë i drejtorive të shëndetit publik, i cili është i detyruar të marrë mostrën dhe ta dërgojë në laborator. Normal, subjekti ka prioritet, analiza bëhet brenda ditës në qoftë se laboratori e merr herët në mëngjes dhe e merr përgjigjen maksimumi brenda 24 orëve, duke pasur parasysh që edhe ata kanë kostot e tyre dhe nuk mund të penalizohen si importues së produkteve, pasi mund të mos kenë vetëm kripë, por edhe produkte të tjera.

(Diskutime pa mikrofon)

Në përgjithësi ne përcaktojmë vetëm jodin, por kur kërkohen tregues të tjerë përcaktohet niveli i lagështirës dhe lënda e patretshme, por në përgjithësi me këtë pjesë nuk ka pasur probleme.

(Diskutime pa mikrofon)

Te subjektet tregtare ne si Ministri e Shëndetësisë kemi dy nivele kontrolli, kontrollin që bën Inspektorati Shëndetësor Shtetëror sipas një plani, si dhe monitorimin e detyruar nga drejtoritë e shëndetit publik të rretheve, monitorim, i cili bëhet përsëri sipas një plani shpërndarjeje që merr në konsideratë numrin e popullatës dhe shpërndarjen fshat-qytet të popullatës dhe përcaktojmë nivelin e pikave ku bëjmë monitorimin në nivel prodhimi, fortifikimi, sepse tashmë për fat të mirë në vend janë shtuar pikat e prodhimit dhe të fortifikimit, gjithashtu edhe në pikat e shumicës dhe të pakicës. Numri i mostrave është i lartë, pasi marrim mbi 2000 mostra në vit dhe t'ju them të drejtën nuk kemi pasur probleme. Sa i përket shqetësimit që u ngrit këtu se subjektet mund të lodhura nga kontrollet, deri më so, të them të drejtën, nuk kemi pasur probleme me këtë histori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e thashë nga përvoja ime. Kam të paktën 12 vjet që jam pjesë e monitorimit, rrallë kemi pasur në ndonjë qytet ose ndonjë tregtar që të thonë mos e merr me lekë. Ndërkohë që inspektorët deri më sot e kanë marrë mostrën me lekë, por nuk është se janë lodhur duke thënë: jo, mos hajdeni të merrni mostrën. Këtë jua them nga përvoja në Institutin e Shëndetit Publik.

Ndërsa drejtoresha flet në kuadrin e kontrollit të inspektimeve, por thashë nuk besoj se do të jetë problem kjo histori, duke marrë në konsideratë që ne duhet t'i japim prioritet, sepse është çështje e shëndetit publik. Jemi gati gjysma popullsisë me deficiencë jodike. Kështu që, për sa kohë që është e tillë, ne duhet ta marrim në konsideratë, përtej kontrollit apo bezdisjes së tregtarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, nga përfaqësuesja e Ministrisë së Bujqësisë u konsiderua pak minore që çështja t'i kalojë AKU-së dhe jo neve. Në fakt, për ne është çështje e madhe, sepse përtej të tjerave, ne kemi pasur edhe probleme për sa i përket bashkëpunimit. Shpesh na ndodhte që inspektori i ushqimit i merrte mostrat e tjera, importuesi ka pasur edhe kripën, dhe e linte të dilte dhe nuk merrte e mostrën kripës që t'i bëhej edhe jodi. Prandaj ne këmbëngulëm që të jetë inspektori ynë aty nga drejtoria e shëndetit publik që të marrë mostrën për jodin. Me thënë të drejtën bashkëpunimi nuk ka qenë efektiv, shpesh na ikte subjekti dhe detyroheshim t'i ktheheshim atij subjekti. Ndërkohë, me të drejtë doganat ndoshta nuk kanë pasur informacion të plotë për sa u përket këtyre dy procedurave midis dy kolegëve tanë inspektorë, dhe të Ministrisë së Bujqësisë. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Oligert Kume – Oligert Kume, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për t'iu përgjigjur doktoreshës në lidhje me vonesat që mund të krijohen në doganë, për produktet e importit të kripës është e përcaktuar jo vetëm në ligjin nr. 9942 të vitit 2009, por, në zbatim të këtij ligji, ka dalë edhe një udhëzim i përbashkët midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave, që kanë normuar procedurën që duhet të ndjekin autoritetet doganore dhe inspektorati shëndetësor në lidhje me kripën e importit që do të paraqitet pranë autoriteteve doganore. Ky udhëzim i përbashkët detyron strukturën doganore që të mos kryejë asnjë veprim procedural pa asistencën e përfaqësuesve të inspektoratit shëndetësor teknik pranë pikave kufitare, ku ka përcaktuar edhe prezencën në çdo pikë kufitare të këtij inspektorati për të qenë i pranishëm pikërisht për marrjen, analizimin, verifikimin, mostrimin dhe, në konkluzion, fletëanalizën për përcaktimin e jodit. Pra, për kripën merret posaçërisht për çështjen e jodit, në zbatim të këtij ligjit, dhe afati i përcaktuar në këtë udhëzim është jo më shumë se 24 orë. Prandaj nuk është një shqetësim real, që edhe nga operatorët ekonomikë, mund të ngrihet si element për vonesa pikërisht për këto shkaqe. Në fakt, në praktikën tonë nuk na ka rezultuar ndonjë ankesë, qoftë pranë portalit, qoftë pranë strukturave lokale të degëve doganore apo në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pikërisht për këtë element procedural që mund ketë shkaktuar vonesa të pajustificuara për operatorët ekonomikë dhe, për rrjedhojë, t'u kenë sjellë dëme ekonomike operatorëve.

Faleminderit!

Ilir Pendavinji - Sa e keni nivelin e gjobave, kur ajo shkruan e jonizuar, por, në fakt, është e pajodizuar? Meqenëse jemi duke e parë këtë ligj, ndoshta është mirë që parashikojmë edhe nivelin e gjobave.

Vjollca Braho - 500 mijë lekë të rinj.

Në bazë të analizave që kryhen nga ana e laboratorëve të ISHP-së, ose të drejtorive rajonale për nivelin e ulët të jodit në kripën, ku ne shkojmë dhe e kontrollojmë është 200 mijë lekë dhe niveli tjetër është 100 mijë lekë, në qoftë se ne pengohemi nga ligji i inspektimit për kryerjen e inspektimit, në mënyrë që të mos marrim mostrat për të analizuar dhe për të gjetur se si është kripa e jonizuar. Kjo ka ndodhur në supermarkete, ndërsa në pjesën e subjekteve, që merren me jodifikimin, nuk na ka ndodhur asnjëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për subjektet, të cilat kushtet e ruajtjes dhe tregtimit të tyre, sigurisht edhe për prodhuesit, në momentin kur shkojmë ne nuk i kanë nivelin e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, masa e gjobës është 500 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Duhet të ulet niveli i përdorimit të kripës në tavolinë, sepse shoqërohet me rritje shumë të lartë të hipertensionit arterial. Mendoj se 40% e popullsisë shqiptare në moshat 30-40 e lartë kanë shifër të konsiderueshme të hipertensionit, në këto kushte përdorimi i kripës së jodizuar në ushqime, është e vetmja mënyrë për të marrë kripën dhe për të zhdukur njëherë e mirë këtë sëmundje.

Fortifikimi i kripës së Himalajës me jod te ju nuk besoj se përbën kosto të madhe financiare?

Hari Lena – Në fakt, unë i dëgjova parafolësit si të doganës, ashtu edhe të shëndetësisë, ne si prodhues për pasurimin e kripës me jod dhe me aditivë të tjerë, por edhe kripa e Himalajës pa problem mund të pasurohet, jo vetëm me jod, por edhe me aditivë të tjerë, ndeshemi me probleme edhe të ligji i vjetër, sepse ai e përcakton qartë që ndalohej të hyjë në Republikën e Shqipërisë kripa e pajodizuar për konsum njerëzor apo përdorim në industrinë ushqimore, por jo të ndalohej kripa si lëndë e parë për industrinë përpunuese dhe pasurimi i saj me jod apo aditivë të tjerë. Këtë nuk e thotë, por deri tani jemi ndeshur, sepse kam 1 vit që po ndeshem me probleme të jashtëzakonshme me kripën. Pra, kemi një kamion me kripë Himalaje dhe ka 1 vit që është ndaluar, kur jemi subjekt që e pasurojmë kripën. Veprime të kësaj natyre nuk duhet të ndodhin, sepse edhe një biznesmen mund të kontraktojë një sasi produkti, por dikush nga vjen kjo kripë mund të abuzojë në atë kompani, pra e kërkon kripën të jodizuar dhe mund

t'ia këtë sjellë të pajodizuar. Ajo lejohet të kalohet, por mbahet e bllokuar diku, pra gjenden mënyra për të...

Enver Roshi – Ne kemi një propozim, ku thuhet: “Lejohen, por domosdoshmëria e përdorimit të kripës së pajodizuar në prodhimin e ushqimeve të vlerësohet dhe të aprovohet paraprakisht nga Komiteti Kombëtar për Eliminim e Pamjaftueshmërisë Jodike”, i cili është i vetmi organ këshillimor, që propozon ndryshimet në sasinë e jodit të kripës së jonizuar në përputhje me OBSH-në”. Pra, lejohet përdorimi i tyre.

Ligji i parë thotë: “Të destinuar për konsum njerëzor-shtazor dhe prodhim në industrinë ushqimore”. Pra, është një zinxhir i tërë, që thotë ligji 1 dhe fusha e zbatimit ligji dytë. Është i gjithë harku i ushqimeve. Pra, zbatimi i ligjit.

Hari Lena – Ne jemi që kemi investuar për këtë punë, jemi plotësisht të interesuar që të ndalohet tërësisht përdorimi i kripës së pajodizuar. Jemi kategorikë. Unë jam partizan: hajdeni të investojmë së bashku me ministritë.

Elona apo doktoresha folën këtu edhe për gratë shtatzëna gjatë gjithë vitit ta japim falas kripën e jonizuar, unë, personalisht, por edhe të tjerët që merren me fortifikimin apo me këtë lloj biznesi, sepse me këtë lloj biznesi janë pak kompani, për të mos thënë se janë 3 kompani.

Problemi është se duhet një kontroll shumë të saktë, duhet një legjislacion shumë i përcaktuar, sepse çfarë na ndodh? Duhet të dimë një gjë: industria e përpunimit dhe fortifikimit të kripës nuk është një ndonjë industri moderne, me kompjuter, por është një industri, domethënë, deri diku artizanale, pra ka ecur, ka avancuar shumë, por mos harroni që nuk mund të përcaktosh jodin, kur themi 40 -60 ppm, sepse vetë kripa nuk është e njëtrajtshme.

Prandaj doja të ndalem këtu, që të mos abuzohet, sepse, kur bëhet një kontroll dhe e gjejmë jodin 37 ppm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shiko çfarë ndodh, sepse unë vetëm këtë vit kam marr 10 gjoba.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

40-60, por, në qoftë se në një kontroll e gjejmë kripën në supermarkete me 35 ppm, ose tek unë në magazinën qendrore 37 PPM ose 33 PPM nuk është ndonjë gjë që ne o burra t'i vëmë gjobë, t'i bëjmë presion për të marrë lekë, sepse duhet të kuptojmë që jetojmë... Kjo duhet të jetë më pak e kujdesshme.

Kurse për sa i përket jodizimit të kripës në industrinë ushqimore, mos i lini evazive këto gjëra, sepse do të ketë shumë probleme. Në qoftë se ne këto i përcaktojmë saktë, gjurmueshmëria është shumë e saktë. Sot unë shkoj dhe blej X produkt, ku e kam dhënë, sepse të mos harrojmë edhe një gjë, vjen kripë nga importi, por prodhohet edhe kripë në vend.

Prodhohen rreth 40 mijë tonë kripë në Vlorë apo ka filluar në Durrës të prodhohet kripë. Kush e kontrollon? Ne flasim këtu, por ditë për ditë nuk e kontrollon njeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht gjurmueshmëria, ngarkohen kamionë dhe hajde t'u them unë se sa jod konsumoj, unë që bëj prodhim, dhe sa jod konsumon dikush, X-i apo Y-i. Ka shumë mënyra. Ne donim që të licencoheshim, sepse nuk na licenconte njeri, sepse askush nuk e njeh këtë industri. Ne flasim për industrinë e kripës dhe mungesën e jodit te njerëzit, por njerëzit përballen ende me pasoja shumë më të mëdha. Shyqyr që këtu është Ministria e Shëndetësisë, por në industri të tjera mund të jenë katastrofale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush i licencon këto? Si mund t'i licencosh këto?

Enver Roshi – Urdhëroni!

Edlira Llango - Shumë shkurt për t'iu rikthyer shqetësimit që ngriti zonja deputete.

Dua ta ritheksoj se ndoshta është qartë se biznesit ushqimor AKU-ja patjetër që do t'i shkojë, në mos për kripën, për çdo produkt tjetër. Kështu që në rastin e kripës do t'i shkojë edhe një inspektorat tjetër. Pra, do të jenë dy inspektorate. AKU-ja nuk mund të eliminohet si kontrollues në biznesin ushqimor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, do të jemi në situatën konkrete që për kripën do të shkojë një inspektorat i posaçëm vetëm për kripën. Kjo është edhe kosto për buxhetin e shtetit dhe të tjera me radhë. Megjithatë, nëse vendimmarrja, sikundër është aktualisht në ligjin ekzistues, që të jetë e ndarë, pra vetëm për nivelin e jodit të jetë inspektorati në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, ne do të donim që të qartësohej mirë në ligj, sepse në nenin përkatës thuhet: “Kripa e jodizuar është objekt kontrolli e të tjera me radhë”. Duhet të thuhet: “Niveli ose përmbajtja e nivelit të jodit në kripën e jonizuar të jetë...”. Kjo është për çështje qartësie kompetencash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mund ta bëjë AKU-ja marrjen e mostrave, sepse edhe në pikë është i përhershëm inspektori i AKU-së, sigurisht sipas rregullave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, madje t'i çojë edhe në laboratorët përkatës.

Enver Roshi – Ju falënderoj shumë për ekspertizën e frytshme, shumë të nevojshme që na sollët këtu, sepse mësova shumë gjëra nga industria, nga doganat, nga inspektorati!

Falënderoj veçanërisht Ministrinë e Shëndetësisë, që e solli këtë ligj në komisionin tonë, për të zhdukur një herë e mirë problemin e deficiencës jodike në Shqipëri.

Falënderoj përfaqësuesit e doganave, Hari Lenën, Institutin e Shëndetit Publik, profesoreshtë Jolandën, UNICEF-in, Ministrinë e Bujqësisë, Inspektoratin, kryeinspektorin dhe të gjithë kolegët e tjerë për sugjerimet e dhëna këtu!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA